



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - Ministarstvo za Administracije Lokalne
Samouprave- Ministry of Local Government Administration

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, bënë:

Shpallje të Konkursit Publik
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit:	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Njësia Organizative:	Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Titulli i punës:	Zyrtar për lektorim të dokumenteve ligjore dhe dokumenteve tjera në gjuhën serbe
Numri i referencës:	07/2016/ DLMK\MAPL
Niveli i pagës:	437.55€
Raporton te:	Udhëheqësi i Divizionit për Monitorim të Komunave
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Tre (3) muaj
Orari i punës:	I plotë /40 orë në javë
Numri i zyrtarëve:	1 (Një)
Vendi:	Prishtinë/Ndërtesa Qeveritare “Ish Pallati i Rilindjes”

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën lekturimin e pavarur dhe cilësorë të teksteve apo të përkthyer në gjuhën serbe;
- Bënë përzgjedhjen e terminologjisë njësore që përdoret në hartimin e ligjeve, udhëzimeve , shkresave zyrtare dhe dokumenteve tjera në Ministri;
- Bën lekturën e procesverbaleve , raporteve , draft ligjeve dhe shkresave tjera në MAPL;
- Përkujdeset për strukturën sintaksore të dokumenteve;
- Përdorë teknikën moderne për kryerjen e lekturës në kompjuter;

-Ofron përkrahjen ndaj përkthyesve të gjuhës serbe për ngritjen e cilësisë së përkthimit me shkrim dhe simultant si dhe
-Kryen edhe punë tjera nga kjo fushë sipas kërkesës së Udhëheqësit të Divizionit.

Shkathtësitë e kërkua: *(Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

- E preferueshme kualifikimi universitar(Fakulteti i Gjuhëve)
- Përvojë pune profesionale e preferueshme;
- Të jetë i aftë të përballojë dhe të organizojë punën;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve;
- Njohja e mirë e programeve (Word, Excel, Power Point, MS-Office dhe Internetit);
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe bashkëpunim në ekip;
- Njohuri e gjuhës angleze e preferueshme;

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal/Divizioni për Burime Njerëzore, zyra nr. 1204 kati XII, ndërtesa e qeverisë, “Ish Rilindja”, Prishtinë, ose mund të shkarkohen në veb-faqen <http://mapl@rks-gov.net>

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike, nga dita e publikimit në faqen zyrtare të MAPL-së. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 2 ditësh; aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin arsimor, letërnjoftimin dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet. Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen!

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

MAPL-ja mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni Divizionin e Burimeve Njerëzore.

Tel. 038 200 35555, prej orës 8:00 – 16:00.